

STRUKTURAT AKOMODUESE (tour_occ)

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

Agjensia: INSTAT

Periudha referenciale: 2023-A0

Ofruesi i të dhënave: SSA

Data Flow: TOUR_ESMSSP_A

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore	2
4. Njësia matëse	5
5. Periudha e referencës	5
6. Mandati institucional.....	5
7. Konfidencialiteti	6
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	7
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	7
11. Manaxhimi i cilësisë	8
12. Rëndësia	9
13. Saktësia dhe besueshmëria	10
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	11
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria	11
16. Kostoja dhe ngarkesa	12
17. Rishikimi i të dhënave.....	12
18. Përpunimi statistikor	13
19. Komente	15
Aneks	15

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave Afatshkurtra, Drejtoria e Statistikave Ekonomike
1.3. Personi i kontaktit	Ervisa Bushati
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Statistikave Afatshkurtra
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Tiranë, Kodi Postar 1017.
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	ebushati@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	20.02.2024
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	20.02.2024
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	20.02.2024
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Qëllimi i vrojtimit mbi strukturat akomoduese dhe njësitë e tjera të ngjashme me to është monitorimi i aktiviteteve turistike; të mbledhë tregues të rëndësishëm për ofertën turistike; ecurinë e netë qëndrimeve dhe vizitorëve, dhoma, shtretër, etj; për të llogaritur treguesit statistikorë mbi ofertën e akomodimit të turizmit shqiptar në periudha mujore, të cilat janë të rëndësishme për të përcaktuar ecurinë e zhvillimit të kapacitetit në sektorin e turizmit. Të dhënat mblidhen çdo muaj përmes pyetësorit "Anketa e Strukturave Akomoduese".</p> <p>Variablat e mbledhura nga vrojtimi janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri i vizitorëve rezident; • Numri i vizitorëve jo – rezident;

	<ul style="list-style-type: none"> • Netët e qëndrimit nga vizitorët rezident; • Netët e qëndrimit nga vizitorët jo - rezident; • Dhomat/kampet e zëna nga vizitorët rezident; • Dhomat/kampet e zëna nga vizitorët jo - rezident; • Numri i dhomave/kampeve gjithsej; • Numri i shtretërve gjithsej; • Numri i ditëve të mbyllura gjatë muajit të referencës; <p>Mbledhja e këtyre treguesve dhe llogaritja e niveleve të kapacitetit dhe shfrytëzimit realizohen pjesërisht në përputhje me Aneksin I “Oferta turistike-Statistikat e Akomodimit” të Rregullores së Bashkimit European (EU) no. 692/2011.</p>
<p>3.2. Sistemi i klasifikimit</p>	<p><u>NVE Rev. 2</u></p> <p>Strukturat akomoduese turistike klasifikohen dhe përshkruhen në grupe sipas klasifikimit NVE Rev. 2 si vijon:</p> <p><i>55.10 Hotele dhe akomodime të ngjashme.</i> Kjo klasë përfshin: hotele, resort hotelier (kompleks turistik), hotel suite / apartament, motele.</p> <p><i>55.20 Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime afatshkurtra.</i> Kjo klasë përfshin: shtëpi pushimi për fëmijë dhe të tjerë, apartamente dhe shtëpi njëkatëshe për vizitorë, shtëpi pushimi familjare pa shërbim në dhomë, bujtina të rinjsh dhe streha malore.</p> <p><i>55.30 Hapësirat për kampingje dhe për parqe, për çadra ose rulota argëtimi.</i> Kjo klasë përfshin kampingje e parqe për çadra, automjete ose rulota për vizitorët me qëndrim të shkurtër.</p> <p><u>NUTS II</u></p> <p>Rajonet statistikore në nivelin 1, 2 dhe 3 përcaktohen sipas ndarjes territoriale NUTS II, i cili është një klasifikim i unifikuar dhe përdoret si bazë për mbledhjen dhe përpunimin e Statistikave Rajonale Evropiane. Informacioni më poshtë përfshin se cilat prefektura janë në rajonin e Veriut, Qendrës dhe Jugut.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rajoni i Veriut: Dibër, Durrës, Kukës, Lezhë, Shkodër; 2. Rajoni Qendër: Elbasan, Tiranë; 3. Rajoni i Jugut: Berat, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Vlorë. <p><u>Zonat bregdetare</u></p> <p>Zonat bregdetare janë Njësi Administrative Vendore (LAU) që janë në kufi ose afër një vijë bregdetare. Zonat bregdetare klasifikohen sipas dy kategorive të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zonat bregdetare: LAU që kufizohen me vijën bregdetare ose LAU që kanë të paktën 50% të sipërfaqes së tyre në një distancë prej 10 km nga vija bregdetare;

	<ul style="list-style-type: none"> • Zonat jo-bregdetare: LAU që nuk janë "zona bregdetare"; që nënkupton LAU që nuk kufizohen me vijën bregdetare dhe kanë më pak se 50% të sipërfaqes së tyre në një distancë prej 10 km nga vija bregdetare. <p>Komentet shtesë: Klasifikimi NUTS III dhe DEGURBA nuk aplikohet.</p>				
3.3. Mbulimi i sektorit	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="432 389 683 741">3.3.1 Kapaciteti</td> <td data-bbox="683 389 1505 741"> <p>Përfshihen: të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.10 me 10 ose më shumë të punësuar; të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.02 dhe 55.30.</p> <p>Për ndërmarrjet e vogla të klasifikuara në 55.10, merret një kampion, duke përdorur shtresimin sipas madhësisë së ndërmarrjes.</p> <p>Sipas Rregullores 692/2011, NVE 55.1, 55.2 dhe 55.3 janë të mbuluara.</p> </td> </tr> <tr> <td data-bbox="432 741 683 1097">3.3.2 Shfrytëzimi</td> <td data-bbox="683 741 1505 1097"> <p>Përfshihen: të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.10 me 10 ose më shumë të punësuar; të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.02 dhe 55.30.</p> <p>Për ndërmarrjet e vogla të klasifikuara në 55.10, merret një kampion, duke përdorur shtresimin sipas madhësisë së ndërmarrjes.</p> <p>Sipas Rregullores 692/2011, NVE 55.1, 55.2 dhe 55.3 janë të mbuluara.</p> </td> </tr> </table>	3.3.1 Kapaciteti	<p>Përfshihen: të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.10 me 10 ose më shumë të punësuar; të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.02 dhe 55.30.</p> <p>Për ndërmarrjet e vogla të klasifikuara në 55.10, merret një kampion, duke përdorur shtresimin sipas madhësisë së ndërmarrjes.</p> <p>Sipas Rregullores 692/2011, NVE 55.1, 55.2 dhe 55.3 janë të mbuluara.</p>	3.3.2 Shfrytëzimi	<p>Përfshihen: të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.10 me 10 ose më shumë të punësuar; të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.02 dhe 55.30.</p> <p>Për ndërmarrjet e vogla të klasifikuara në 55.10, merret një kampion, duke përdorur shtresimin sipas madhësisë së ndërmarrjes.</p> <p>Sipas Rregullores 692/2011, NVE 55.1, 55.2 dhe 55.3 janë të mbuluara.</p>
3.3.1 Kapaciteti	<p>Përfshihen: të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.10 me 10 ose më shumë të punësuar; të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.02 dhe 55.30.</p> <p>Për ndërmarrjet e vogla të klasifikuara në 55.10, merret një kampion, duke përdorur shtresimin sipas madhësisë së ndërmarrjes.</p> <p>Sipas Rregullores 692/2011, NVE 55.1, 55.2 dhe 55.3 janë të mbuluara.</p>				
3.3.2 Shfrytëzimi	<p>Përfshihen: të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.10 me 10 ose më shumë të punësuar; të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.02 dhe 55.30.</p> <p>Për ndërmarrjet e vogla të klasifikuara në 55.10, merret një kampion, duke përdorur shtresimin sipas madhësisë së ndërmarrjes.</p> <p>Sipas Rregullores 692/2011, NVE 55.1, 55.2 dhe 55.3 janë të mbuluara.</p>				
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>Konceptet dhe përkufizimet statistikore bazohen në Rregulloren 692/2011 dhe <u>Manualin Metodologjik për Statistikat e Turizmit</u>.</p> <p><u>Përkufizime:</u></p> <p>Struktura akomoduese në statistikat e akomodimit përfshin të gjitha njësitë e akomodimit turistik që ofrojnë, si një shërbim të paguar (çmimi mund të subvencionohet pjesërisht ose plotësisht), shërbime akomodimi afatshkurtra ose qëndrimi të shkurtër.</p> <p>Dhomë: është njësi e përbërë nga një dhomë ose grupe dhomash të cilat janë të marra me qira nga vizitorët (turistët) si një e tërë (qira e pandashme).</p> <p>Shtrat: përcaktohet nga numri i personave që mund të qëndrojnë gjatë natës në një shtrat, duke përjashtuar shtretërit ekstra të vendosur sipas kërkesës së vizitorit.</p> <p>Vizitorë: një vizitorë është përcaktuar si një person i cili qëndron të paktën një natë në hotel duke përfshirë edhe fëmijët.</p> <p>Rezident: konsiderohet ai person që ka banuar në Shqipëri për më shumë se 12 muaj radhazi.</p> <p>Jo-Rezident: konsiderohet ai person që nuk ka banuar në Shqipëri për më</p>				

	<p>shumë se 12 muaj radhazi.</p> <p>Netë qëndrimi: është çdo natë që një vizitor / turist (rezident ose jo-rezident) shpenzon (fle apo qëndron) në një njësi akomodimi.</p> <p>Norma neto e shfrytëzimit të shtretërve = $\frac{\text{Numri i netë qëndrimeve}}{\text{Numri i shtretërve të disponueshëm}} * 100$ që mat përqindjen e shfrytëzimit të shtretërve për “Hotelet dhe akomodime të ngjashme”.</p> <p>Norma neto e shfrytëzimit të dhomave = $\frac{\text{Numri i dhomave të zëna}}{\text{Numri i dhomave të disponueshme}} * 100$ që tregon përqindjen e shfrytëzimit të dhomave për “Hotelet dhe akomodime të ngjashme”.</p>	
3.5. Njësia statistikore	<p>Njësitë vendore me sektorë ekonomikë: NVE Rev.2 55.1; 55.2; 55.3 sa herë që ky informacion është i disponueshëm në <i>nivel të njësisë</i> vendore; dhe ndërmarrjet me aktivitete kryesore / dytësore në NVE Rev.2 55.1; 55.2; 55.3. Mbulimi statistikor është në përputhje me Rregulloren nr. 692/2011.</p>	
3.6. Popullata statistikore	<p>Të gjitha njësitë vendore (strukturat akomoduese) që ofrojnë akomodim me qëndrim të shkurtër si një shërbim të paguar (edhe pse çmimi mund të jetë pjesërisht ose tërësisht i subvencionuar) për turistët siç përcaktohet në NVE Rev.2 55.1, 55.2 dhe 55.3.</p>	
3.7. Zona e referencës	<p>Statistikat e akomodimit mbulojnë gjithë territorin e Shqipërisë.</p>	
3.8. Mbulimi në kohë	<p>3.8.1 Hotele dhe akomodime të ngjashme (NVE 55.1) (Viti)</p> <p>3.8.2 Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime afatshkurtra (NVE 55.2) (Viti)</p> <p>3.8.3 Hapësirat për kampingje dhe për parqe, për çadra ose rulota argëtimi, etj. (NVE 55.3) (Viti)</p>	<p>2018</p> <p>2018</p> <p>2018</p>
3.9. Periudha bazë	<p>Nuk aplikohet.</p>	
4. Njësia matëse	<p>Kapaciteti: Vlera absolute. Shfrytëzimi: Vlera absolute dhe përqindje.</p>	
5. Periudha e referencës	<p>5.1 Kapaciteti</p> <p>5.2 Shfrytëzimi</p>	<p>2023</p> <p>Vjetore = 2023 Mujore = Gusht 2023</p>
6. Mandati institucional		
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>6.1.1 Niveli European</p> <p>6.1.2 Niveli Kombëtar</p>	<p>Regullore 692/2011; Regullore 1051/2011.</p> <p>Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” ; Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare, 2022-2026.</p>

6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Seria kohore e të dhënave mujore ka filluar të dërgohet në EUROSTAT në shtator 2020, me periudhë referuese nga janar 2018 e në vazhdim për indikatorët kryesorë.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura nga ndërmarrjet konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare , si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikën zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk u shpërndan palëve të treta të dhënat e mbledhura nga, apo tek të cilat ka akses, të dhëna këto që mund të shërbejnë në identifikimin drejtpërsëdrejti apo tërthorazi të njësive statistikore që i kanë ofruar të dhënat në fjalë për arsye dhe qëllime statistikore, apo të dhëna të vjela nga burime të tjera administrative. INSTAT ndërmerr tërë masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga Instituti i statistikave vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor;</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave.</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i Institutit të Statistikave. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajeve që mund të shpërdahet dhe të bëhet publike nga Instituti i Statistikave, me qëllim që të bëhet i pamundur identifikimi i njësisë statistikore nga këto të dhëna; kriteret e anonimizimit për të dhënat mikro që u ofrohen përdoruesve; dhënia e aksesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendar i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftimet dhe

	vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesimi në kalendarin e publikimeve	Kalendari i Publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesimi i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara (by mail or e-mail); 3. Publikimi; 4. Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Rezultatet e Statistikave të Strukturave Akomoduese 2023 janë publikuar në bazë mujore.
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Publikimi i rezultateve mbi statistikave të Strukturave Akomoduese është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT. Formatimi i njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit. Njoftimi për shtyp i anketës së Strukturave Akomoduese publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Rezultatet e Statistikave të Strukturave Akomoduese janë publikuar në një botim të dedikuar, Turizmin në shifra , Vjetarin Rajonal Statistikor dhe Shqipëria në shifra .
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha të dhënat janë në dispozicion në të dy gjuhët shqip dhe anglisht. Rezultatet mbi Anketën e Strukturave Akomoduese janë të vendosura në bazën e të dhënave statistikore dhe mund të gjenden në linkun: Databaza . Shifrat gjithashtu janë të disponueshme edhe në format excel ku publikohen treguesit kryesorë, dhe tabelat mund të gjenden në linkun: Shifrat .
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat e Anketës së Strukturave Akomoduese në nivel mikro nuk bëhen të disponueshme, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 31, pika 7 ligji nr. 17/2018, datë 17.04.2018 "Për statistikave zyrtare".

10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet në linkun: Kërkesë të dhënash .	
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër në lidhje me përkufizimet e koncepteve kryesore dhe shpjegimet metodologjike u ofrohen përdoruesve në fund të njoftimeve për shtyp dhe botimeve. Informacion shtesë mbështetës u jepet përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme ose e kërkuar.	
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave Afatshkurtra dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e Anketës së Strukturave Akomoduese për qëllime të brendshme.	
11. Manaxhimi i cilësisë		
11.1. Sigurimi i cilësisë	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p>	
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>11.2.1 Pikat e forta</p> <p>11.2.2 Dobësitë kryesore</p>	<p>Të gjitha kërkesat e Rregullores merren në konsideratë, shkalla e përgjigjes është nën kontroll, të dhënat dhe raporti i cilësisë janë lehtësisht të arritshme për përdoruesit, etj.</p> <p>Një nga kufizimet kryesore të cilësisë në këto vërtetime mujore lidhet me faktin se stafi përgjegjës i dizenjimit të kampionit të INSTAT-it duhet të mbështetet në punësimin si një "përfaqësues" i kapacitetit të strukturave të akomodimit të turizmit, në vend të numrit të shtretërve, i cili nuk është i disponueshëm në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve. Fakti që INSTAT nuk posedon informacion të plotë mbi kapacitetin e të gjitha strukturave në Listën e ndërmarrjeve të synuara, gjithashtu nuk e lejon atë të përjashtojë njësitë që janë opcionale të Rregullores. Një numër i konsiderueshëm i njësive të cilat u zgjedhën në kampionin fillestar rezultojnë të jenë të papërshtatshme. Këto njësi në terren rezultuan se: ushtronin aktivitete të ndryshme nga ai i akomodimit (njësi jashtë fushe); ishin të mbyllura; ishte e pamundur të gresh njësinë sipas adresës në Regjistrin Statistikor të Biznesit (njësi pa kontakt). Gjatë analizës së të dhënave, njësitë jashtë qëllimit të</p>

		<p>anketës (pa kontaktet) trajtohen si refuzim (imputohen ose kompensohen me pesha). Rezulton se ky problem është prezent në ndërmarrjet e vogla.</p>				
	11.2.3 Përmirësimet e cilësisë krahasuar me vitin e kaluar të referencës	Në kampionin e vitit 2023 u përfshinë të gjithë njësitë nga lista e popullatës së synuar (ndërmarrje) të klasifikuara në 55.02 dhe 55.30 sipas NVE.Rev 2.				
12. Rëndësia						
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>2.1.1 Përdoruesit kryesorë në nivel Evropian</p> <p>Shih: Rregullorja 692/2011</p> <p>2.1.2 Përdoruesit kryesorë në nivel kombëtar</p> <p>Përdoruesit kryesorë janë autoritetet kombëtare, institucionet publike dhe agjencitë, media, subjektet kërkimore dhe të biznesit, universitetet, studentët, përdoruesit ndërkombëtarë (EUROSTAT, UNWTO, OECD). Përfaqësuesit e përdoruesve kryesorë të të dhënave statistikore janë anëtarë të Këshillit të Statistikave. Roli kryesor i Këshillit është të përmbushë nevojat e gamës më të gjerë të përdoruesve.</p>					
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>INSTAT analizon çdo vit klikimet e faqes web dhe klikimet në lidhje me temën “Statistikat e Turizmit, Anketën e Strukturave Akomoduese” për vitin 2023 janë 17,031.</p> <p>INSTAT kryen çdo vit vërtetimin për matjen e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p> <p>Rezultatet e vërtimit për 2023 tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës “Statistikat e Turizmit, Anketën e Strukturave Akomoduese ” është vlerësuar me me 4.00 pikë (80.0%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p>					
12.3. Plotshmëria	<p>12.3.1 Plotshmëria</p> <table border="1"> <tr> <td>12.3.1.1 Plotshmëria</td> <td>Pjesërisht në përputhje me kërkesat e Rregullores mbi statistikën e turizmit 692/2011 si dhe rekomandimet e përcaktuara në Manualin Metodologjik për statistikën e turizmit.</td> </tr> <tr> <td>12.3.1.2 Nëse nuk është i plotë, ju lutemi specifikoni pse dhe renditni devijimet nga Rregullorja</td> <td> <ul style="list-style-type: none"> Metodologjia e përdorur për mbledhjen e të dhënave nuk është plotësisht në përputhje me rregulloren. Kampioni është dizajnuar duke përdorur numrin e punonjësve për stratat, si tregues i kapacitetit, si dhe variabël ndihmës në fazën e alokimit të kampionit të strukturave të akomodimit turistik, në vend të numrit të </td> </tr> </table>		12.3.1.1 Plotshmëria	Pjesërisht në përputhje me kërkesat e Rregullores mbi statistikën e turizmit 692/2011 si dhe rekomandimet e përcaktuara në Manualin Metodologjik për statistikën e turizmit.	12.3.1.2 Nëse nuk është i plotë, ju lutemi specifikoni pse dhe renditni devijimet nga Rregullorja	<ul style="list-style-type: none"> Metodologjia e përdorur për mbledhjen e të dhënave nuk është plotësisht në përputhje me rregulloren. Kampioni është dizajnuar duke përdorur numrin e punonjësve për stratat, si tregues i kapacitetit, si dhe variabël ndihmës në fazën e alokimit të kampionit të strukturave të akomodimit turistik, në vend të numrit të
12.3.1.1 Plotshmëria	Pjesërisht në përputhje me kërkesat e Rregullores mbi statistikën e turizmit 692/2011 si dhe rekomandimet e përcaktuara në Manualin Metodologjik për statistikën e turizmit.					
12.3.1.2 Nëse nuk është i plotë, ju lutemi specifikoni pse dhe renditni devijimet nga Rregullorja	<ul style="list-style-type: none"> Metodologjia e përdorur për mbledhjen e të dhënave nuk është plotësisht në përputhje me rregulloren. Kampioni është dizajnuar duke përdorur numrin e punonjësve për stratat, si tregues i kapacitetit, si dhe variabël ndihmës në fazën e alokimit të kampionit të strukturave të akomodimit turistik, në vend të numrit të 					

		<p>shtretërve siç kërkon rregullorja përkatëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mosdisponueshmëria e një klasifikimi të krahasueshëm DEGURBA. • Për shkak të mungesës së informacionit mbi kapacitetin e këtyre institucioneve, nuk ka qenë e mundur të eliminohen njësitë e vogla me më pak se 20 shtretër (ose 20 kampe për kamping) nga popullata e synuar, të cilat janë opcionale për Rregulloren. • Gjatë vitit 2023 të dhënat mujore janë transmetuar në Eurostat 1 javë me vonesë.
<p>12.3.2 Threshold-et e përdorura ("kufizimet e qëllimit të vrojtimit")</p>		
	<p>12.3.2.1 Hotele dhe akomodime të ngjashme (NACE 55.1)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përfshihen: të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.10 me 10 ose më shumë të punësuar; të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.02 dhe 55.30. • Për ndërmarrjet e vogla të klasifikuara në 55.10, merret një kampion, duke përdorur shtresimin sipas madhësisë së ndërmarrjes. <p>Sipas Rregullores 692/2011, NACE 55.1, janë të mbuluara.</p>
	<p>12.3.2.2 Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime afatshkurtra (NACE 55.2)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përfshihen: të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.10 me 10 ose më shumë të punësuar; të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.02 dhe 55.30. • Për ndërmarrjet e vogla të klasifikuara në 55.10, merret një kampion, duke përdorur shtresimin sipas madhësisë së ndërmarrjes. <p>Sipas Rregullores 692/2011, NACE 55.1, janë të mbuluara.</p>
	<p>12.3.2.3 Hapësirat për kampingje dhe për parqe, për çadra ose rulota argëtimi, etj. (NACE 55.3)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përfshihen: të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.10 me 10 ose më shumë të punësuar; të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.02 dhe 55.30. • Për ndërmarrjet e vogla të klasifikuara në 55.10, merret një kampion, duke përdorur shtresimin sipas madhësisë së ndërmarrjes. <p>Sipas Rregullores 692/2011, NACE 55.1, janë të mbuluara.</p>
<p>13. Saktësia dhe besueshmëria</p>		
<p>13.1. Saktësia e përgjithshme</p>	<p>Kontrollet e cilësisë dhe vlefshmëria e të dhënave janë veprime të kryera gjatë gjithë procesit. Ekziston problemi i mungesës së një regjistri të dedikuar për strukturat akomoduese, i cili përfshin të gjitha variablat e nevojshëm për të prodhuar statistika cilësore të turizmit. Ky regjistër do të mund të kontribuojë në një zvogëlim gradual të gabimeve të under-coverage. Shkalla e under-coverage është e panjohur, sepse nuk e dimë saktësisht se sa është numri aktual i të gjitha strukturave të akomodimit në Shqipëri. Vrojtimet mujore kanë ndihmuar në</p>	

	marrjen e një informacioni shumë të saktë në lidhje me under-coverage, dhe ky problem ekziston vetëm me njësitë e vogla. Njësitë që ofrojnë akomodim nuk janë gjithmonë të regjistruara në aktivitetet përkatëse në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve (veçanërisht Njësitë Vendore).									
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet.									
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Mos-përgjigja mujore vlerësohet në rreth 5.4 % dhe informacioni që mungon imputohet duke përdorur metoda të përshtatshme matematikore që marrin të dhëna të periudhave të mëparshme.</p> <p>Shkalla e mos-përgjigjes në nivel treguesi për treguesit kryesorë është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri gjithsej i vizitorëve rezidentë gjatë muajit është 0 %; • Numri gjithsej i netë qëndrimeve gjatë muajit nga vizitorët rezidentë është 0 %. <p>Shkalla e mbi-mbulimit është i mundur kur një njësi regjistrohet në një aktivitet të caktuar objekt i anketimit dhe gjatë procesit të intervistimit ajo nuk është më objekt i anketimit, ose kur njësia e vrojtuar nuk është më aktive.</p> <p>Shkalla e mbi mbulimit për Anketën e Strukturave Akomoduese është 1.5 %.</p>									
14. Afatet kohore dhe përpikmëria										
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e Anketës së Strukturave Akomoduese publikohen në faqen e internetit të INSTAT 51 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 51 ditë). Periudha e referencës të rezultateve të Anketës së Strukturave Akomoduese është 31 Dhjetor, 2023.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>2/20/2024</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>51</td> </tr> </table>		Periudha referuese	12/31/2023	Data e publikimit	2/20/2024	Afatet kohore	51		
Periudha referuese	12/31/2023									
Data e publikimit	2/20/2024									
Afatet kohore	51									
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat e Anketës së Strukturave Akomoduese janë publikuar sipas kalendarit të botimit. Publikimi i Anketës së Strukturave Akomoduese ka qenë i përpiktë në kohë në 100% të botimeve të kryera gjatë vitit.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>2/20/2024</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>2/20/2024</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>		Periudha referuese	12/31/2023	Data e shpallur	2/20/2024	Data e publikimit	2/20/2024	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2023									
Data e shpallur	2/20/2024									
Data e publikimit	2/20/2024									
Vonesa në kohë	0									
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria										
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat janë plotësisht të krahasueshme. Shiko pikën 3.7									
15.2. Krahasueshmëria kohore	15.2.1 Hotele dhe akomodime të ngjashme (NACE 55.1)	Shiko pikën 3.8.1								

	15.2.2 Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime afatshkurtra (NACE 55.2)	Shiko pikën 3.8.2
	15.2.3 Hapësirat për kampingje dhe për parqe, për çadra ose rulota argëtimi, etj. (NACE 55.3)	Shiko pikën 3.8.3
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk ka burim tjetër të të dhënave të ngjashme për kapacitetin dhe shfrytëzimin e strukturave akomoduese me të cilat mund të bëhen krahasime ose imputime.	
15.4. Koherenca e brendshme	Koherenca midis të dhënave vjetore dhe mujore: Koherenca e plotë.	
16. Kostoja dhe ngarkesa	<p>Personeli që punon për Anketën e Strukturave Akomoduese është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 1 specialist i fushës së turizmit (Sektori i Statistikave Afatshkurtra); • 1 specialist metodologjie (Sektori i Metodologjisë); • 1 specialist IT (Sektori i Zhvillimit të Programeve Kompjuterike); • 1 specialist (Sektori i Planifikimit dhe Menaxhimit të Mbledhjes të të Dhënave); • 14 personel nga Zyrat Rajonale; • 27 personel anketues; • 1 kontrollor (Sektori i Koordinimit të Mbledhjes të të Dhënave). 	
17. Rishikimi i të dhënave		
17.1. Politika e rishikimit	17.1.1 Kapaciteti	<p>Politika e rishikimit bëhet në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantuara nga INSTAT në lidhjet më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit; • Politika e trajtimit të gabimeve.
	17.1.2 Shfrytëzimi	<p>Politika e rishikimit bëhet në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantuara nga INSTAT në lidhjet më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit; • Politika e trajtimit të gabimeve.
17.2. Praktika e rishikimit	17.2.1 Kapaciteti	<p>Pas datës së përfundimit së periudhës referuese, periudha referuese do të mbetet subjekt i rishikimeve dhe mund të rishikohet në rastin e sigurimit të informacionit më të përditësuar nga të anketuarit, si dhe nëse do të ketë ndryshime të reja metodologjike. Rishikimi i muajit paraardhës është i mundur gjatë çdo muaji dhe rregullimet mund të bëhen në fund të çdo viti për dymbëdhjetë muajt. Do të konsiderohet si përfundimtar varianti i fundit në mënyrë që të shmanget thyerja e serive.</p>
	17.2.2	<p>Pas datës së përfundimit së periudhës referuese, periudha</p>

	<p>Shfrytëzimi referuese do të mbetet subjekt i rishikimeve dhe mund të rishikohet në rastin e sigurimit të informacionit më të përditësuar nga të anketuarit, si dhe nëse do të ketë ndryshime të reja metodologjike. Rishikimi i muajit paraardhës është i mundur gjatë çdo muaji dhe rregullimet mund të bëhen në fund të çdo viti për dymbëdhjetë muajt. Do të konsiderohet si përfundimtar varianti i fundit në mënyrë që të shmanget thyerja e serive.</p>																		
18. Përpunimi statistikor																			
18.1. Burimi i të dhënave	<p>18.1.1 Burimi i të dhënave</p> <table border="1" data-bbox="435 600 1497 853"> <tr> <td>18.1.1.1 Burimi i të dhënave</td> <td>Anketa</td> </tr> <tr> <td>18.1.1.2 Emri i anketës së mbledhjes së të dhënave në gjuhën shqipe</td> <td>Anketa e Strukturave Akomoduese</td> </tr> <tr> <td>18.1.1.3 Emri i anketës së mbledhjes së të dhënave në gjuhën angleze</td> <td>Accommodation Establishments Survey</td> </tr> </table> <p>18.1.2 Popullata e synuar</p> <p>18.1.2.1 Korniza e popullatës së synuar</p> <table border="1" data-bbox="435 920 1497 1084"> <tr> <td>18.1.2.1.1 Kapaciteti</td> <td>Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve (T-2)</td> </tr> <tr> <td>18.1.2.1.2 Shfrytëzimi</td> <td>Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve (T-2)</td> </tr> </table> <p>18.1.2.2 Përditësimi i kornizës së popullatës së synuar</p> <table border="1" data-bbox="435 1128 1497 1240"> <tr> <td>18.1.2.2.1 Kapaciteti</td> <td>Mujor</td> </tr> <tr> <td>18.1.2.2.2 Shfrytëzimi</td> <td>Mujor</td> </tr> </table> <p>18.1.2.3 Komente të tjera ose shtesë</p> <p>18.1.2.4 Gabimet në mbulim të kornizës së popullatës së synuar</p> <table border="1" data-bbox="435 1352 1497 1464"> <tr> <td>18.1.2.4.1 Kapaciteti</td> <td>Nuk aplikohet</td> </tr> <tr> <td>18.1.2.4.2 Shfrytëzimi</td> <td>Nuk aplikohet</td> </tr> </table> <p>18.1.3 Dizenjimi i kampionit</p> <p>Përfshihen: të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.10 me 10 ose më shumë të punësuar; të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara në 55.02 dhe 55.30. Për ndërmarrjet e vogla të klasifikuara në 55.10, merret një kampion, duke përdorur shtresimin sipas madhësisë së ndërmarrjes.</p> <p>18.1.4 Komente të tjera ose shtesë mbi burimin e të dhënave, kornizën e popullatës së synuar ose dizenjimin e kampionit (p.sh. ndryshimet për klasën NACE).</p> <p>Në kampionin e vitit 2023 u përfshinë të gjithë njësitë nga lista e popullatës së synuar (ndërmarrje) të klasifikuara në 55.02 dhe 55.30 sipas NVE.Rev 2.</p>	18.1.1.1 Burimi i të dhënave	Anketa	18.1.1.2 Emri i anketës së mbledhjes së të dhënave në gjuhën shqipe	Anketa e Strukturave Akomoduese	18.1.1.3 Emri i anketës së mbledhjes së të dhënave në gjuhën angleze	Accommodation Establishments Survey	18.1.2.1.1 Kapaciteti	Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve (T-2)	18.1.2.1.2 Shfrytëzimi	Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve (T-2)	18.1.2.2.1 Kapaciteti	Mujor	18.1.2.2.2 Shfrytëzimi	Mujor	18.1.2.4.1 Kapaciteti	Nuk aplikohet	18.1.2.4.2 Shfrytëzimi	Nuk aplikohet
18.1.1.1 Burimi i të dhënave	Anketa																		
18.1.1.2 Emri i anketës së mbledhjes së të dhënave në gjuhën shqipe	Anketa e Strukturave Akomoduese																		
18.1.1.3 Emri i anketës së mbledhjes së të dhënave në gjuhën angleze	Accommodation Establishments Survey																		
18.1.2.1.1 Kapaciteti	Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve (T-2)																		
18.1.2.1.2 Shfrytëzimi	Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve (T-2)																		
18.1.2.2.1 Kapaciteti	Mujor																		
18.1.2.2.2 Shfrytëzimi	Mujor																		
18.1.2.4.1 Kapaciteti	Nuk aplikohet																		
18.1.2.4.2 Shfrytëzimi	Nuk aplikohet																		
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të	Të dhënat janë përpiluar në bazë mujore.																		

dhënave		
18.3. Grumbullimi i të dhënave	18.3.1 Tipi i Vrojtimit	
	18.3.1.1 Kapaciteti	Vrojtim pranë ndërmarrjeve që realizon INSTAT-i
	18.3.1.2 Shfrytëzimi	Vrojtim pranë ndërmarrjeve që realizon INSTAT-i
	18.3.2 Metoda e mbledhjes së të dhënave	
	18.3.2.1 Kapaciteti	Intervistë Personale me Tablet
18.3.2.2 Shfrytëzimi	Intervistë Personale me Tablet	
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	18.4.1 Kapaciteti	Për ndërmarrjet që plotësojnë pyetësin mujor, ekzistojnë një numër kontrollesh paraprake cross-validation me qëllim të kufizimit të gabimeve të hedhjes së të dhënave në program. Nëse gjendet ndonjë gabim, INSTAT kontakton si fillim me anketuesin, zyrën rajonale, në fund me të anketuarin dhe gabimi korrigjohet. Sapo të dhënat ngarkohen në bazën e të dhënave qendrore, zbatohet një numër i konsiderueshëm vlerësimesh, kontrollesh cross-sectional dhe longitudinal dhe për çdo editim të mundshëm vendoset shënim në seksionin e dedikuar “Shënime”. Nëse përsëri pas kësaj faze gjenden gabime apo jo konsistencë në të dhënat individuale të ndërmarrjeve, rifillon procesi i kontaktimit si fillim me anketuesin, zyrën rajonale, dhe në fund me të anketuarin. Gabimi editohet dhe përsëri për çdo editim të mundshëm vendoset shënim në seksionin e dedikuar “Shënime”.
	18.4.2 Shfrytëzimi	Për ndërmarrjet që plotësojnë pyetësin mujor, ekzistojnë një numër kontrollesh paraprake cross-validation me qëllim të kufizimit të gabimeve të hedhjes së të dhënave në program. Nëse gjendet ndonjë gabim, INSTAT kontakton si fillim me anketuesin, zyrën rajonale, në fund me të anketuarin dhe gabimi korrigjohet. Sapo të dhënat ngarkohen në bazën e të dhënave qendrore, zbatohet një numër i konsiderueshëm vlerësimesh, kontrollesh cross-sectional dhe longitudinal dhe për çdo editim të mundshëm vendoset shënim në seksionin e dedikuar “Shënime”. Nëse përsëri pas kësaj faze gjenden gabime apo jo konsistencë në të dhënat individuale të ndërmarrjeve, rifillon procesi i kontaktimit si fillim me anketuesin, zyrën rajonale, dhe në fund me të anketuarin. Gabimi editohet dhe përsëri për çdo editim të mundshëm vendoset shënim në seksionin e dedikuar “Shënime”.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Të dhënat e munguara në nivel ndërmarrjeje imputohen duke përdorur metoda të përshtatshme matematikore me të dhënat e periudhave të mëparshme. Ndonjëherë	

	identifikohen të dhëna jo konsistente në nivel ndërmarrje ose treguesi, të cilat duhet të fshihen. Hapi tjetër është imputimi në nivel ndërmarrje ose treguesi sipas rastit, duke përdorur të dhënat e periudhave të mëparshme. Në disa raste, gjithashtu përdoren teknika matematikore (imputim hot-deck). Kurdoherë që hotelet e mëdha nuk përgjigjen, informacioni që mungon nuk mund të mbulohet nga peshat; prandaj duhet të vendosim të gjithë informacionin e tij në setin e të dhënave. Dhe kjo bëhet përsëri përmes të dhënave të kaluara dhe teknikave statistikore.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komentë	
Aneks	